

Komuna e Prishtinës
Municipality of Prishtina

Prishtina, po bëhet

Raporti një vjeçar
Komuna e Prishtinës 2014

Vizioni ynë për Prishtinën

Prishtina e së ardhmes është qytet me shërbime efikase e cilësore të cilat janë në funksion të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të saj.

Qytet me planifikim urban e hapësinor të mirëfilltë, i cili e bën kryeqytetin qendër të sigurt për një jetë të begatshme socio-ekonomike, kulturore, arsimore, sportive, dhe duke siguruar mirëqenie dhe cilësi të jetës për qytetarët e komunës së Prishtinës.

Qytet me model të qeverisjes efikase dhe transparente, dhe si i tillë, të shërbejë si model edhe për qeverisje në komunat tjera në Kosovë, duke ndikuar kështu në rritjen e mirëqenies për tërë qytetarët e Kosovës.

Kur kemi shpalosur vizionin tonë për Prishtinën, në fillim na është thënë se është ambicioz dhe vështirë i arritshëm, por një vit pas, të gjithë së bashku jemi dëshmitarë se vizioni ynë për Prishtinën po jetësohet.

Vetëm brenda vitit të parë të qeverisjes tonë, kemi treguar një qasje krejt ndryshe ndaj postit publik dhe parasë publike. Kemi bërë transparente të gjitha vendimet dhe të gjitha raportet buxhetore dhe raportet e punës së secilës drejtori. Komuna është e të gjithëve dhe buxheti është i qytetarëve të Prishtinës, prandaj gjatë gjithë kohës kemi raportuar në mënyrë të rregullt dhe jemi përkujdesur që menaxhimi dhe shpërndarja e buxhetit të bëhet në mënyrë të drejtë e të barabartë.

Ne, që në fillim kemi thënë se Prishtina nuk bëhet qytet i të gjithë neve pa u instaluar rregulli dhe ligji, dhe tash, pas një viti mund të themi se në vitin e parë të qeverisjes sonë kemi instaluar rendin dhe ligjin në Komunën e Prishtinës dhe kemi mbajtur ritmin e lartë e dinamikën e punës, duke realizuar projekte të shumta, që kanë përmirësuar dukshëm jetën e qytetarëve të Prishtinës.

Realizimi i vizionit

Rruga për realizimin e vizionit tonë për Prishtinën nuk është e lehtë dhe pa sfida. Deri më sot ne jemi përballur me vështirësi të shumta dhe do të vazhdojmë të përballemi edhe në vitet e ardhshme. Përkundër vështirësive, ekipi qeverisës vazhdon të jetë i përkushtuar për të realizuar vizionin.

Ekipi qeverisës që nga marrja e mandatit ka pasur për qëllim, dhe vazhdon ta ketë, realizimin e 12 premtimeve për ta bërë Prishtinën qytet me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, duke ju mundësuar atyre të kenë qasje në shërbime efikase dhe duke siguruar një treg vendor të zhvilluar, trafik urban të rregulluar, planifikim urban e hapësinor, arsim dhe shërbime shëndetësore cilësore, krijim të kushteve për banim të përballueshëm, qasje të lehtë për qytetarë në shërbimet komunale përmes dixhitalizimit të shërbimeve, dhe transparencë të plotë, ku qytetarët kanë siguri dhe janë të barabartë.

Vetëm brenda vitit 2014 ne kemi arritur t'i realizojmë plotësisht gjysmën e premtimeve dhe kemi filluar me realizimin e premtimeve tjera. Përtej premtimeve ne kemi realizuar edhe shumë projekte tjera të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe funksionimin më të mirë të qytetit.

Ne jemi të lumtur që gjatë vitit 2014, Komuna e Prishtinës është mbikëqyrur shumë më tepër se të gjitha institucionet e tjera. Kjo është vetëm një shenjë që ky vit i qeverisjes sonë ka qenë ndryshe. Besojmë se në një të ardhme të afërt, llogaridhënia do të jetë standard në të gjitha institucionet qeveritare, dhe se kjo qeverisje dhe kjo llogaridhënie si në Prishtinë të bëhet standard i raportimit.

12 ZOTIMET 2014-2017

PËR MANDATIN 2014-2017 NE PREMTUAM:



FURNIZIM I PANDËRPRERË ME UJË PËR 24 MUAJ

- Vlerësimi i humbjeve
- Plani i investimeve kapitale
- Realizimi i investimeve



ÇERDHE ME KOSTO TË PËRBALLUESHME NË ÇDO PJESË TË KOMUNËS

- Vlerësimi i nevojave
- Diskutimet publike
- Plani aksional për çerdhet



ARSIMI NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT

- Përzgjedhja e drejtove me pjesëmarrje në komunitet
- Vlerësimi i punëtorëve të arsimit në baze të performancës
- Shujta falas për klasat I-V
- Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve



TREGU I PRODHIMEVE TË VENDIT

- Tregu për buqit vendor që në Prishtinë t'i shesin prodhimet e tyre pa taksa shtesë
- Lidhja në mes të institucioneve dhe grupeve të tjera në Prishtinë me prodhuesin vendor



VENDOSJA E RREGULLIT NË PLANIFIKIM URBAN

- Planet rregullative
- Përfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve
- Ndalja e ndërtimeve pa leje



BARAZI NË PRISHTINË

- Programi për qasje në institucionet publike për personat me nevoja të veçanta
- Programi i integritimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Heqja e taksave administrative për rastet sociale dhe programe për lirim nga pagesa për shërbimet komunale për grupet e rrezikuara



RREGULLIMI I TRAFIKUT NË PRISHTINË

- Reformimi i transportit publik
- Sistem i ri i linjave me orar të parashikueshëm, dhe që mbulon të gjitha lagjet e qytetit
- Sistem i ri i pagesave
- Transporti falas për pensionistë, raste sociale dhe grupe të tjera të rrezikuara



BANIM I PËRBALLUESHËM

- Banim i përballueshëm për punëtorë të sektorit publik
- Mundësi për shërbyesit publik që shërbejnë më shumë se 10 vite në sektorin publik



HAPJA E KOMUNËS PËR QYTETARËT

- Kërkesat administrative kanë përgjigje para afatit ligjor
- Qytetarët informohen nga Komuna për kërkesat e tyre
- Publikimi i raporteve financiare çdo tre muaj
- Prokurimi sipas modelit të transparencës radikale
- Punësim sipas modelit të anonimitetit që është provuar në shtetet e Bashkimit Evropian



SHËNDETI NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT

- Zonimi i qytetit: çdo banorë ka mjekun e vet
- Sistemi i informimit në shëndetësi, çdo banorë ka kartelën e vet digjitale
- Shërbime të rregullta mjekësore e stomatologjike në shkolla për qëllime preventive
- Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre



REFORMIMI I TATIMIT NË PRONË

- Shkallët e reja të tatimit në pronë sipas gjendjes materiale dhe numrit të banorëve në objektet banesore



VENDIMMARRJA NË LAGJE

- Funkcionalizimi i bashkësive lokale për ti përmbush nevojat e qytetarëve
- Riorganizimi i këshillave të lagjeve dhe ndërtesave

VETËM GJATË VITIT 2014 REALIZUAM PLOTËSISHT:

ÇERDHE ME KOSTO TË PËRBALLUESHME NË ÇDO PJESË TË KOMUNËS

- ✓ Vlerësimi i nevojave – Është bërë vlerësimi i nevojave për çerdhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat e Komunës së Prishtinës, dhe në bazë të këtij vlerësimi kemi përgatitur planin aksional për hapjen e çerdheve të reja me çmim të përballueshëm në çdo pjesë të Prishtinës.

ARSIMI NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT

- ✓ Përzgjedhja e drejtorëve me pjesëmarrje në komunitet
- ✓ Shujta falas për klasat I - V
- ✓ Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve – Tashmë në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës, të ciklit të ulët, janë vendosur dollapët për secilin fëmijë.
- ✓ Vlerësimi i punëtorëve në bazë të kualifikimeve në gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të tretë – Pas inspektimit të gjithë dokumentacionit të mësimdhënësve në gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të tretë, kemi gjetur se një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve nuk kanë përgatitje të duhura profesionale për të ligjëruar në shkolla të mesme, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, Ligjit të Arsimit Parauniversitar dhe Udhëzimit Administrativ.



TREGU I PRODHIMEVE TË VENDIT

- Treg për bujqit vendor – Tashmë kemi nënshkruar grantin e fituar nga Komisioni Evropian, në vlerë prej 400 mijë euro (totali i projektit është 500 mijë euro), për krijimin e tregut të prodhimeve vendore. Nga muaji janar Prishtina do të ketë tre tregje lëvizëse të prodhimeve vendore, që do të lëvizin nga lagja në lagje me ç’ rast fermerët e rajonit të Prishtinës do të kenë mundësinë të promovojnë dhe shesin prodhimet e tyre drejtpërdrejt tek qytetarët.
-

VENDOSJA E RREGULLIT NË PLANIFIKIM URBAN

- Ndalja e ndërtimeve pa leje dhe implementimi i Ligjit të ndërtimit
-

RREGULLIMI I TRAFIKUT NË PRISHTINË

- Transporti falas për pensionistë - për linjat 3 dhe 4
 - Zonimi për parking – Zona Qendër (1)
-

HAPJA E KOMUNËS PËR QYTETARËT

- Publikimi i raporteve financiare
 - Prokurimi transparent – Është ofruar qasje e plotë në prokurim për shoqërinë civile dhe qytetarët
 - Certifikata online – për 48 orë në shtëpi
 - Sistemi i pritjes
 - “One Stop Shop”
 - Kemi aprovuar 97% të kërkesave për qasje në dokumentet publike dhe 3% kanë qenë kërkesa të pa definuara mirë
-

SHËNDETI NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT

- Vizita të rregullta sistematike mjekësore e stomatologjike, të cilat tash e tutje do të bëhen çdo vit
-

BARAZI NË PRISHTINË

- Heqja e taksave administrative për rastet sociale dhe grupet e rrezikuara
- Lirimi nga pagesa e shërbimeve komunale për rastet sociale dhe grupet e rrezikuara

VENDIMMARRJE NË LAGJE

- Tubimet në lagje – Proces i vazhdueshëm. Vetëm brenda këtij viti, Komuna e Prishtinës ka mbajtur mbi 50 takime me banorë të lagjeve e fshatrave për çështje të ndryshme.

REFORMIMI I TATIMIT NË PRONË

- Rritja e arkëtimit të tatimit në pronë – 31% më shumë arkëtim sesa në vitin 2013
- Vendosja e sistemit të monitorimit mujor të ekzekutimit të buxhetit
- Vendosja e procesit të mirëfilltë të përpilimit të buxhetit komunal, sipas parimit nga poshtë-lart

NË PROCES:

FURNIZIM I PANDËRPRERË ME UJË PËR 24 MUAJ

Vlerësimi i humbjeve – Kemi përfunduar raportin për burimet alternative. Mbetet përfundimi i raportit për distribucionin. Ujësullësi Rajonal “Prishtina” ka zëvendësuar gypat e ujit në një pjesë të madhe të qytetit dhe ndërtimi i fabrikës së ujit ka filluar më 10 nëntor 2014.

Problemi kryesor mbetet kompetencat e përziera, ku nuk merret plotësisht përgjegjësia. Duke pasur parasysh se 70% e konsumatorëve të Ujësullësit Rajonal “Prishtina” janë banorë të Prishtinës, ne si Komunë po bëjmë çmos që Komuna e Prishtinës të ketë më shumë kompetenca.

Plani i investimeve kapitale – Ka përfunduar për burime, ndërsa është në proces për distribucion (rrjet)

Realizimi i investimeve – Të gjitha investimet pritet të realizohen në vitin 2015

ÇERDHE ME KOSTO TË PËRBALLUESHME NË ÇDO PJESË TË KOMUNËS

Çerdhja “Botanika” në Mat – Çerdhja “Botanika” në lagjen “Mati” është çerdhja e parë ku do të aplikohet modeli me bazë në komunitet. Deri më tani kemi zgjedhur Këshilli i prindërve, kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin për regjistrimin e çerdhes, është rinovuar objekti, është përzgjedhur kompania për furnizim me inventar dhe mjete didaktike. Në janar do të hapet konkursi për pranim të udhëheqësit të çerdhes dhe edukatoreve, ku më pas do të fillojmë me regjistrimin e fëmijëve.

Çerdhja “Ngjyrat” në lagjen “Hajvalia” – Është zgjedhur Këshilli i prindërve, kanë filluar përgaditjet për regjistrim. Jemi në fazën e fundit të renovimit. Tenderi për furnizim me mjete didaktike dhe inventar do të hapet në fillim të muajit janar.

Çerdhja në Besi – Është zgjedhur Këshilli i prindërve, kanë filluar përgaditjet regjistrim dhe ka filluar procesi i shndërrimit të objektit në çerdhe.

Çerdhja në lagjen “Arbëri” – Konkursi për ndërtimin e çerdhes në lagjen “Arbëria” është mbyllur. Në muajin janar do të bëhet vlerësimi dhe përzgjedhja e projektit më të mirë dhe në pranverë do të fillojmë me ndërtimin e çerdhes në këtë lagje, që do të kushtoj 200.000 euro, e cila do të financohet nga projekti “Kosova e Bukur” dhe Komuna e Prishtinës.

TREGU I PRODHIMEVE TË VENDIT

Treg për bujqit vendor –Nga muaji janar, Prishtina do të ketë tri tregje lëvizëse të prodhimeve vendore, që do të lëvizin nga lagja në lagje, ku fermerët e rajonit të Prishtinës do të kenë mundësinë të promovojnë dhe shesin prodhimet e tyre drejtpërdrejt tek qytetarët.

ARSIMI NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT

Vlerësimi i punëtorëve në bazë të kualifikimeve dhe performancës – Është proces i vazhdueshëm i cili ka filluar dhe do të bëhet gjatë tërë kohës.

Lidhja e shkollave me rrjetin e internetit – Shumica e shkollave në Komunën e Prishtinës kanë qasje në internet. Kanë mbetur vetëm 5 shkolla të cilat do të lidhen me internet në fillim të viti 2015 "Azemi e Salihu" në Dabishevc, "Rilindja"-Keqekollë,"Ramiz Sadiku" në Bullaj,"Liria" dhe "Fan S.Noli" në Marec.

Shkolla te sigurta – Në bashkëpunim të ngushtë me MASHT-in, UNICEF-in, KEC-in, Save the Children, Syri Vizionit dhe Policinë e Kosovës, Komuna e Prishtinës ka hartuar platformën për siguri në shkolla 2015-2018. Kjo platformë parasheh të gjitha masat dhe investimet e nevojshme që do të ndërmarr Komuna për të adresuar problemet e dhunës dhe sigurisë në shkollat e Komunës së Prishtinës.

VENDOSJA E RREGULLIT NË PLANIFIKIM URBAN

Përfundimi i procesit të legalizimit – Kemi filluar me trajtimin e ndërtimeve pa leje.

- Është bërë caktimi dhe sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme profesionale për zbatim efektiv dhe formimin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje
- Ka filluar kontraktimi i punëve shtesë të nevojshme për zbatim efektiv dhe efikas të formimit të regjistrimit për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe procesit në tërësi.
- Është bërë sigurimi dhe pranimi i hartës ortofoto - digjitale nga MMPH ku tregohen të gjitha ndërtimet pa leje në komunën e Prishtinës
- Hartimi dhe sponsorizimi i formularit standard "Kërkesë për t'u shënuar në listën e ndërtimeve pa leje" është i gatshëm për publikun në zyrat e Komunës dhe në kuadër të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje në internet
- Deri më tani në sektorin e legalizimit është bërë regjistrimi i 6000 lëndëve paraprake të cilat kanë aplikuar në afatin e parë të Legalizimit (2010 viti) në mënyrë që të inkorporohen në regjistrin komunal të ndërtimeve pa leje dhe më vonë në regjistrin kombëtar të Kosovës
- Ka filluar digjitalizimi i dosjeve të objekteve të ndërtuara në qytetin e Prishtinës nga viti 1950

Planet rregullative - Ka filluar hartimi i planeve rregullative në lagjet "Kodra e Trimave", "Vreshtat", "Velani-Dodona","Bërnice e Ulët", "Bërnice e Epërme", "Bardhosh", "Mati II". Ndryshimi dhe plotësimi i planeve rregulluese në lagjet "Dodona ", " Tophane ", " Qendra 1" . Tani e tutje planet rregullative do të bëhen vetëm me konkurse.

Analizë për zgjidhjen urbane të blloqeve - Lagjen Mati I, Blloqet B17, B18, B19, B20 dhe Blloku C7; lagjen Prishtina e Re - Zona Perëndim, Blloku C2; lagjen "Prishtina e Re" - Zona Qendër, Blloku B17 dhe Blloku A4; lagjen "Tophane", Blloku T13.

RREGULLIMI I TRAFIKUT NË PRISHTINË

Reformimi i transportit publik – Ka filluar reforma për reformimin e trafikut urban në bashkëpunim me BERZH. Deri më tani është bërë: i) vlerësimi teknik dhe ambiental, do të vazhdohet ii) me planin e mobilitetit që do t'i caktojë linjat e reja, iii) prokurimi i autobusëve të rinj, së bashku me BERZH përmes tenderit ndërkombëtar dhe do të përfundojë me sistemin e integruar të biletave.

Politika për kufizimin e qarkullimit të makinave në qendër – Në proces.

Themelimi i kompanisë publike “Parkingu Prishtina” – Ka kaluar në Kuvendin Komunal dhe është dërguar për miratim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Zonimi për parking – Kemi përfunduar me zonim në Zonën I (Qendër) dhe në fillim të vitit 2015 do të vazhdojmë me zonat II dhe III. Deri më tani janë sinjalizuar 680 parkingje në zonën qendër në rrugët “Rexhep Luci”, “Fehmi Agani”, “Rinia” dhe “Enver Zymberi”. Parkingjet tjera do të sinjalizohen në fillim të vitit.

Lirimi i trotuareve – Deri më tani, masat anti-parking janë vendosur në këto rrugë: “Gorge Bush”, “Don Mark Sopi”, “Peramdori Justinian”, “Fehmi Agani”, “UÇK”, “Rexhep Luci”, “Luan Haradinaj”, “Qamil Hoxha”, “Ilir Konusheci”, “Ardian Krasniqi”, “Idriz Gjilani”, “Ilaz Kodra”, “Eqrem Cabej”, “Lidhja e Prizrenit”, dhe “Demokracia”.

BANIM I PËRBALLUESHËM

Banim i përballueshëm – Kemi filluar të punojmë në planprogramin e banimit, program 3 vjeçar, për tu ballafaquar me nevojat e familjeve sociale si dhe për të realizuar konceptin banimit publik.

SHËNDETI NË SHËRBBIM TË ZHVILLIMIT

Zonimi i qytetit – Sapo të kemi zhvillimin e Sistemit Informativ Shëndetësor(SISH) nga niveli qendror, do të fillojmë me zonimin e qytetit. Në anën tjetër, DSHMS-ja ka filluar hapat e parë drejt këtij zotimi, me shtrirjen e infrastrukturës për internet në QKMF dhe hapjen e ueb-faqes për këtë institucion, me të gjitha informacionet për shërbimet që i ofron kjo qendër për qytetarët.

Kartelat digjitale shëndetësore për çdo qytetarë – Ngritja e digjitalizimit dhe zoonimit adekuat do të shkoj paralelisht edhe me përgatitjen e pajisjes së secilit qytetarë me kartelë digjitale.

Ka filluar **rregullimi i infrastrukturës për internetin në QKMF** dhe kjo pritet të vazhdojë edhe në qendrat tjera gjatë vitit 2015.

Është në hartim e sipër **ueb faqja për QKMF-në** e cila përveç informimit të saktë të qytetarëve për shërbimet që ofron KPSH-ja në Prishtinë, do të bëjë publike edhe të gjitha aktivitetet e kësaj qendre, duke përfshirë edhe ato financiare.

Projekti kryesor i parkut ne lagjen Dardania prapa bulevardit "Bill Klinton"



- OLIVETET
- QIELBRIMI
- RSUJET
- SHITQIET PER KEMESORE
- DRINJET EKZISTUES
- DRINJET E PROPOZUAR
- ZONAT E PROPOZUARA PER LULE
- KENCI PER FEMAJE
- KENCI PER SHAM
- KENCI





BARAZI NË PRISHTINË

Programi i integritit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla dhe aktivitete kulturore dhe sportive – Në komunën e Prishtinës kemi 293 fëmijë, të cilët janë përfshirë në shkollat e rregullta dhe në çerdhet publike. Kemi filluar të punojmë në strategjinë e Komunës e cila nuk ka për qëllim të përfshijë të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta nëpër shkolla dhe çerdhe, por t'i ndihmojë këta fëmijë që të jenë pjesëmarrës aktiv në aktivitete kulturore dhe sportive.

Përmirësimin e infrastrukturës për lëvizje të pakufizuar dhe qasje më të lehtë në të gjitha institucionet publike komunale – Në të gjitha projektet infrastrukturore që kemi përfunduar gjatë vitit 2014 dhe që do të kryhen në vitet e ardhshme, kemi marrë parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta, personave të moshuar dhe nënave me fëmijë, në mënyrë që të bëjmë Prishtinën qytet të qasshëm për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Instalimi i ashensorit në ndërtesën e vjetër të Komunës – Kemi filluar përgatitjet për instalimin e ashensorit në ndërtesën e vjetër të Komunës, dhe pritet të përfundojë në pjesën e parë të vitit 2015, duke bërë ndërtesën e Komunës të qasshme për personat me nevoja të veçanta, personat e moshuar dhe nënat me fëmijë.

Instalimin i ashensorëve në Qendrat e Mjekësisë Familjare – Kanë kaluar të gjitha procedurat administrative dhe brenda një periudhe dy mujore, pritet që të instalohen ashensorët në KMF dhe QMF Nr.6 ku të gjithë qytetarët me nevoja të veçanta, personat në moshë të shtyrë dhe nënat me fëmijë do të kenë qasje në çdo shërbim shëndetësor brenda komunës së Prishtinës.

ELIMINIMI I DALLIMEVE, PRIVILEGJEVE DHE LARGIMI I LUKSIT NGA QEVERISJA KOMUNALE

Shitja e veturës AUDI Q7 - Kryetari i Komunës që nga fillimi ka bërë publike se do të shesim veturën Audi Q7, e cila ka shërbyer si makinë zyrtare për ish-kryetarin. Vetura deri më tani është nxjerrë tri herë në ankand për shitje, por për shkak të çmimit të lartë nuk ka pasur të interesuar për blerjen e kësaj veture. Vetura nuk është përdoruar asnjëherë nga Kryetari dhe nuk do të përdoret por do të dalë prapë në shitje.

MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE

Lirimi i pronës komunale nga uzurpimet – Ky është proces i vazhdueshëm, në të cilin jemi duke punuar intensivisht.

Evidentimi i të gjitha pronave komunale – projekti i bashkë financuar me “Swiss Helvetas” përfundon në janar të vitit 2015

VENDIMMARRJA NË LAGJE

Funksionalizimi i Bashkësive Lokale – Procesi i funksionalizimit të bashkësive lokale ka filluar, dhe po bëhet në bashkëpunim me projektin zviceran “Demos”.

Këshillat e lagjeve – Për shkak të punëve në ndërtesat kolektive, janë krijuar këshillat e pronarëve në shumë ndërtesa dhe në disa lagje. Po ashtu jemi në pritje të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e ligjit për ndërtesat në bashkëpronësi.

HAPJA E KOMUNËS PËR QYTETARË

Qasja “online” në tatimin në pronë – Pritet të përfundojë në pranverë të vitit 2015

NDALIMI I PARREGULLSIVE DHE JOKONFORMITETEVE

Rishikimi i kontratave kornizë për furnizime me materiale të ndryshme për nevojat e institucioneve komunale.

PRISHTINA E SIGURTË

Zgjerimi, mirëmbajtja dhe modernizimi i rrjetit të vjetruar të ndriçimit publik –

Kemi bërë zgjerimin e drriçimit në 61 rrugë dhe kemi filluar me fazën e dytë të rekonstruktimit dhe zgjerimit të ndriçimit në këto lokacione: në fshatin Sharban, rrugët “Dritan Hoxha”, “Xhevat Qena”, “Selami Pulaha” dhe “Fehmi Lladrovci”, në parkingjet në rrugën “Tirana”, Lakrishte, te shkolla “Xhemajl Mustafa”, në rrugën “Rexhep Luci” dhe prapa rrugës “Rexhep Luci”.

Vendosja e matësve të shpejtësisë afër shkollave “Model”, “Ismail Qemali” dhe “Hoxhë Kadri Prishtina”. Në vitin 2015, do të vazhdohet me vendosjen e matësve të shpejtësisë afër të gjitha shkollave të Prishtinës.

Ngritja e vendkalimeve për të përmirësuar sigurinë – Në 15 pikat më të frekuentuara të qytetit dhe afër shkollave të qytetit, është bërë ngritja e vendkalimeve për këmbësor duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e aksidenteve në këto rrugë “George Bush”, “Luan Hardinaj”, “Fehmi Agani”, “Enver Maloku”, “Lidhja e Prizrenit” (afër shkollës “Meto Bajraktari”), “Lidhja e Prizrenit”, afër shkollës së Gjelbër, afër shkollës “Eqrem Çabej” dhe në rrugën “Vëllezërit Fazliu” (afër shkollës Asim Vokshi). Në vitin 2015 do të vazhdohet me ngritjen e vendkalimeve në të gjitha rrugët e Prishtinës.

Përtej premtimeve...

ARSIMI

- ✓ Hapja dhe aktivizimi i e-maileve zyrtarë për të gjitha IEAA-të e Prishtinës
 - ✓ Regjistrimi në i fëmijëve në çerdhe dhe shkolla vetëm me kritere. Këtë vit janë pranuar vetëm 35 nxënës në klasat e dhjeta
 - ✓ Pajisjet e shkollave me kabinete të shkencave
 - ✓ Furnizimi i sallave të sportit me rekuizita sportive
 - ✓ Funkcionalizimi i qendrave për ngritje profesionale
 - ✓ Përmirësimi i infrastrukturës në 43 objekte shkollore dhe 6 objekte parashkollore
-

TRANSPARENCA

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë civile për monitorim të punës së Komunës - Komuna e Prishtinës ka bërë marrëveshje me Lëvizjen "FOL" për monitorimin e prokurimit në çdo fushë.
 - ✓ Çdo komunikim në mes të punësuarve bëhet përmes e-mail adresave zyrtare. Posta elektronike nuk është përdorur nga punëtorët Komunës dhe shumica e adresave elektronike zyrtare kanë qenë të mbyllura. Me marrjen e detyrës menjëherë kemi bërë hapjen dhe funksionalizimin e sistemit të postës elektronike.
 - ✓ Plani për Integritet - Në muajin korrik të këtij viti, kemi publikuar "Planin për Integritet të Komunës së Prishtinës", me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Përmes aplikimit të këtij plani Komuna do të jetë më, efektive, transparente në shërbimet që ofron dhe projektet që implementon për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj.
-

LUFTË NDAJ SJELLJEVE KORRUPTIVE

- ✓ Suspendimi i zyrtarëve komunal të dyshuar për korrupsion - Komuna e Prishtinës ka pezulluar zyrtarë komunalë që janë në procese gjyqësore për korrupsion. Mbi 70 raste janë dërguar në Prokurorinë e Shtetit dhe një pjesë tjetër pritet të dërgohet së shpejti.
-

NDALIMI I PARREGULLSIVE DHE JOKONFORMITETEVE

- ✓ Shkëputja e kontratës dhe padia ndaj HIB Petrol-it - Komuna ka identifikuar se nëpër shkollat e Komunës së Prishtinës, nga 42 mostra që janë testuar, është vërtetuar se është përdorur lëndë djegëse e dëmshme. Prokuroria ka vërtetuar se në të gjitha shkollat niveli i sulfurit Komuna ka qenë deri në 80 herë më i madh se niveli i lejuar. Për të vërtetuar nivelin e lartë të sulfurit ka dërguar mostrat për analiza edhe në një laborator jashtë vendit (në Itali) dhe rezultatet janë të njëjta, niveli i sulfurit ka qenë 800ppm teksa norma e lejuar është 10ppm. Zbatimi i plotë i Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit - Ky ligj nuk ishte zbatuar plotësisht deri me datën 01.04.2014.

NDALIMI I KEQPËRDORIMIT TË TË MIRAVE TË PËRBASHKËTA

- ✓ Ndalimi i shfrytëzimit të hapësirave publike pa leje - Gjatë këtij viti kemi bërë lirim të 384 lokacioneve publike nga tavolinat dhe karriget e lokaleve afariste, largimin e 283 shitësve ambulantë, 8 aksione për largime të vazove të betonit, etj.

Ndalimi i keqpërdorimeve të ujit të pijes - Inspektorët kanë bërë 500 kontrollime për keqpërdorim të ujit të pijshëm dhe, në bashkëpunim me KUR "Prishtina", kemi bërë intervenimin për sanimin e gypave të ujit të pijshëm në 25 lokacione, si dhe hapjen e 30 pusetave të kanalizimit në Prishtinë.

PËRMIRËSIMI I CILËSISË NË SHËRBIMET MJEKËSORE

- ✓ Përzgjedhja e shefave dhe personelit të QKMF-ve në bazë të kriterëve në formë transparente e në mbikëqyrje edhe të OJQ-ve, sindikatave e Komitetit për shëndetësi.
- ✓ Rishikimi i shpërndarjes adekuate të personelit dhe rishpërndarja e tyre - bazuar në kriterë transparente dhe sipas nevojës.
- ✓ Është zgjidhur keqkuptimi me Bashkësinë Islame lidhur me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Lagjen e Muhaxherëve dhe aty kanë filluar punimet të cilat janë duke shkuar me intensitet të mirë e pritet të mbarojnë para afatit të përcaktuar.
- ✓ Përpilimi strategjisë së punës për përmirësimin e shërbimeve mjekësore.
- ✓ Në këtë vit u formua Komiteti për Promovim dhe Edukimin Shëndetësor dhe në kuadër të kësaj u organizuan disa aktivitete nëpër çerdhet dhe shkollat e Prishtinës me synim të vetëdijesimit dhe edukimit të fëmijëve rreth shëndetit.
- ✓ Shërbimi Stomatologjik me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër vendbanimeve të qytetarëve, ka bërë që shërbimet stomatologjike nëpër QMF, punktet të cilat kanë punuar vetëm me një ndërrim, të punohet tanimë me dy ndërrime. Në QMF IV për shkak të ngarkesës së madhe dhe infrastrukturës së gatshme, kemi funksionalizuar edhe një ordinancë me 2 ekipe, dhe tani kemi 4 ekipe në dy ordinanca të shërbimit stomatologjik në QMF IV.
- ✓ Organizimi i punës së kujdestarisë 24 orëshe të punëtorit social, ku prezenca e punëtorit social është më se e domosdoshme dhe asnjë intervenim apo intervistë pa prezencën e punëtorit social nuk mund të zhvillohet.



DINAMIKË E RE E BASHKËPUNIMIT

Komuna e Prishtinës ka bashkëpunim të ngushtë me komuna të shteteve të rajonit dhe të Evropës, donatorë të ndryshëm, sindikatat dhe OJQ si dhe me subjektet politike, bazuar në interesin e qytetarëve.

- ✓ Bashkëpunim i ngushtë në fushën e arsimit dhe të sportit në mes të Prishtinës dhe Tiranës
- ✓ Bashkëpunimi me qytetin e Zagrebit është fokusuar në realizimin e projekteve të Komunës në këto çështje:
 - Uji dhe menaxhimi i mbeturinave
 - Planifikimi urban, infrastruktura, zhvillimi i studimeve dhe planeve
 - Zhvillimi i një modeli të përshtatshëm të transportit urban në Prishtinë
 - Planifikimi i shëndetit publik
 - Bashkëpunimi ekonomik midis dy komunave
 - Struktura dhe organizimi i kompanive publike
 - Bashkëpunimi në fushën e kulturës



- ✓ Marrëdhënie bashkëpunimi me universitetet jashtë vendit si ai Politeknik i Milanos dhe Universiteti në Antwerp ne Belgjikë
- ✓ Bashkëpunim me qytetin e Vjenës në fushën e arsimit, transportit publik dhe menaxhimin e mbeturinave
- ✓ Bashkëpunimi Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për realizimin e reformës në trafikun urban
- ✓ Bashkëpunimin me Bashkimin Evropian për krijimin e tregut të prodhimeve vendore
- ✓ Marrëveshje Mirëkuptimi me UNDP-në për të realizuar një hulumtim gjithëpërfshirës (me nxënës, mësime dhënëse e prindër)
- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me Universitetin e Prishtinës (Fakultetin e Arkitekturës, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike) në fushat e planifikimit dhe riorganizimit të qytetit
- ✓ Bashkëpunim e ngushte me GIZ-in, BEP/USAID-in, KEC-in, UNDP-in, UNICEF-in etj për zhvillimin profesional të mësime dhënëseve dhe përmirësimin e cilësisë në shkolla
- ✓ Bashkëpunimi me zyrat e BE-së në Kosovë rreth fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve për punësim për shfrytëzuesit e kategorisë dytë të skemës së asistencës sociale
- ✓ Bashkëpunim i ngushtë me GIZ-in rreth zhvillimit të strategjisë Komunale për shërbimet sociale profesionale e cila nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë

ELIMINIMI I DALLIMEVE, PRIVILEGJEVE DHE LARGIMI I LUKSIT NGA QEVERISJA KOMUNALE

- Ulje në shpenzimet mujore të derivateve për automjetet zyrtare të Komunës - Organizimi më i mirë si dhe shpërndarja e shfrytëzimi më optimal në Drejtoritë ka rezultuar me zvogëlim të shpenzimeve të derivateve.
- Reduktimi i shpenzimeve në dreka dhe darka
- Reduktimi i shpenzimeve në telefona
- Ndalimi i parkimit për automjete private në parkingun anësor - Në parkingun kryesor asnjë automjet privat nuk mund të parkohet, përveç automjeteve të personave me nevoja të veçanta, udhëheqësve të grupeve parlamentare dhe të punëtorëve të sigurimit, ndërrimit të tretë.
- Dorëzimi i të gjitha automjeteve në parkun e automjeteve në fund të orarit të punës. Asnjë veturë nuk mund të qëndrojë jashtë autoparkut pas orarit të punës, përveç automjeteve të cilat përdoren në raste emergjente.

PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS LOKALE DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE SHUMË VJEÇARE

- Në vitin 2014, investimet janë bërë sipas projekteve, ndryshe prej vitit 2013 ku shumica e investimeve janë bërë në mungesë të projekteve. Gjatë vitit 2014 kemi përfunduar projektimin e 60 rrugëve dhe projektimin e 10 kanalizimeve në fshatra e lagje të Komunës. Kemi projektuar edhe 8 mure mbrojtëse dhe dy ura.
- Zhbllokimi i punëve të rreth rrotullimi në Veternik
- Zhbllokimi i punëve të rrethi i Arbërisë
- Zhbllokimi i fillimi i ndërtimit të rrugëve: "Ekrem Rexha", "Enver Maloku", "Rruga në Makoc", "Vlora" etj
- Largimi i kundërmimit nga sheshi
- Ndërprerja e kontratave me kompanitë e papërgjegjshme
- Ngritja e cilësisë së punimeve
- Ndërtimi i kolektorëve (Shkabaj, mbi lumin "Mati" - Kalabri, rregullimi i shtratit të lumit "Prishtina")
- Përmirësimi dhe ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat: Mramor, Sutjeskë, Busi, Shkabaj, Bardhosh-Prugoc, Barilevë, Vranidoll, Bërnice - Sinidoll
- Lidhja e Lagjes "Kalabria" (banesat e arabëve) me rrethrotullimin në Veternik
- Përmirësimi i rrugëve si intervenim i përkohshëm me kubëza të betonit në lagjen Kalabria dhe në lagjen "MATI 1"
- Trajtimi fizik dhe estetik të disa prej rrugëve të kryeqytetit si: Rruga "Rexhep Luci", Rruga "Garibaldi", Rruga "Qamil Hoxha", Rruga "Dëshmorët e Kombit".
- Trajtimi i trotuarit dhe mbjelljes së fidanëve në rrugët "Imzot Nikë Prelaj", "Perandori Justinian", "Sylejman Vokshi", "Tringë Smajli", "Eqrem Qabej" dhe "Fehmi Agani"



QASJE TË LEHTË DHE TË BARABARTË NË AKTIVITETET KULTURORE PUBLIKE

- Përfshirja e shkollave dhe çerdheve publike në organizimet publike në koncertet e organizuara nga Komuna - në Festën e Pavarësisë, Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve 1 qershor, "Prishtina Lexon" dhe Festa e Muzikës.
- Regjistrimi i artistëve dhe sportistëve në Komunën e Prishtinës.
- Regjistrimi i vullnetarëve të rinj të Prishtinës-këtë vit kemi hartuar plan-projektin për vullnetarizmin në Komunën e Prishtinës
- Grumbullimi dhe zgjedhja e repertorit nëpër shkollat fillore për pjesëmarrje në manifestimet dhe organizimet e ndryshme të kulturës.
- Çmimi "Rexhep Luci" për arkitektët

MBROJTA E PUNËTORËVE

- Për çdo kontratë të re e kemi vendosur kushtin e pagës minimale ekuivalente me pagën e të punësuarve në Komunë për barazi (momentalisht 240 euro bruto)
- Sigurimi i kontratave dhe pagesat e pagave në kohë për të gjithë punëtorët që punojnë në kompanitë kontraktuese të Komunës së Prishtinës.
- Realizimi i plotë i të gjitha kërkesave të Sindikatës së Shëndetësisë Primare.
- Realizimi i kërkesave të punëtorëve teknik në shkolla dhe në ambulanca për barazi në paga, dhe zbatim të ligjit të punës në kompanitë kontraktuese të komunës së Prishtinës.
- Formimi i sindikatës së punëtorëve brenda QPS-së në mënyrë që ajo t'i mbroj interesat e punëtorëve ashtu siç e parasheh edhe ligji.
- Qumështi për punëtorët e administratës së Komunës, zjarrfikësit dhe punëtorët e objekteve kulturore -për herë të parë komuna ndan qumësht për punëtorët e saj (182 punëtorë) të cilëve ju takon sipas Rregullores së aprovuar në Kuvendin Komunal, e bazuar në Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës (03/L-212).


SUBVENCIONET

- Ndryshimi i kriterëve dhe procedurave të ndarjes së subvencioneve - Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit Lokal, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale, kanë përpiluar kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët dy janë nga drejtoritë përkatëse dhe tre nga shoqëria civile apo ekspertë të jashtëm.

KOMUNA NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Komuna e Prishtinës këtë vit ndau 50 mijë euro të kursyera gjatë vitit me subvencione, për rastet më të rënda sociale. Kjo shumë modeste u nda, që sado pak të ndihmohen familjet në gjendje të rëndë në festat e fundvitit
- Zgjatja orarit për ofrimin e shërbimeve komunale - Është zgjatur orari i punës për Zyrën e gjendjes civile për shërbimet ndaj qytetarëve, prej 8:30 - 17:30 (e hënë - e premte) si dhe ditën e Shtunë orari është 9:00 - 12:00.
- Është bërë uniformimi i punëtorëve të gjendjes civile - të gjithë punëtorët do të janë të uniformuar dhe bartin ID kartelën në mënyrë që të mund të identifikohen lehtë, nëse qytetari ka vërejtje.
- Përgjigjet në ankesat e qytetarëve brenda afatit të paraparë me Ligj.
- Organizimi i ri i hapësirave pritëse për qytetarët.
- Vulat në çdo bashkësi lokale - Qytetarët nuk kanë nevojë të vijnë për një vulë në Komunë.
- Ofrimi i informacioneve të sakta për përfituesit e Skemës së Asistencës Sociale dhe largimi i taksës së pagesës prej 3 eurove për familjen aplikuese për SAS. Kjo është arritur në bashkëpunimin e ngushtë mes DKSHMS dhe Drejtorisë së Urbanizimit, me ç'rast asnjë nga klientët e Skemës së Asistencës sociale nuk kanë nevojë që të shkojnë në zyrë të Komunës për aplikim por e gjithë puna kryhet nga vet punëtorët e QPS-së dhe kjo ka ndikuar jashtëzakonisht shumë tek përfituesit e SAS-it.
- Kutitë e ankesave të qytetarëve hapen çdo muaj - Kutitë e ankesave nga viti 2010 nuk janë hapur asnjëherë. Rregullorja për kutitë është miratuar në Kuvend dhe kutitë për herë të parë janë hapur në muajin gusht dhe që nga atëherë janë hapur dhe do të hapen çdo muaj.
- Platforma e re për aplikim online - kjo lehtëson aplikimin për dokumentet. Tani qytetarët shënojnë vetëm numrin personal dhe përzgjidhet dokumenti që ju nevojitet.
- Ueb faqja e re e Komunës - Është dizajnuar dhe strukturuar në nivel më të lartë, por duke ju përmbajtur udhëzimit administrativë për mirëmbajtjen e ueb faqeve
- E-rekrutimi - Transparencë e plotë në punësim - Platforma e cila mundëson aplikim "online" për pozitat e lira në Komunë dhe përcjelljen e procesit të rekrutimit për aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe numrin e pikëve të arritura.

Në pyetsorin e organizuar nga Drejtoria e Administratës, se sa janë të kënaqur qytetarët me shërbimet që ofron sektori i ofiqarisë, nga 1590 respondent 1540 janë shprehur shumë të kënaqur, 50 të kënaqur dhe 0 të pakënaqur.



NGRITJA E KAPACITETEVE DHE PËRKRAHJA E STUDENTËVE

- Krijimi i mundësive për studentët e Prishtinës në kryerjen e praktikës profesionale në institucionet komunale - në drejtoritë komunale, shkolla, QPS etj.
- 120 bursa për studentët e Komunës së Prishtinës - Këtë vit Komuna ndan 120 bursa për studentët e Prishtinës që studiojnë në universitetet publike të Kosovës për vitin akademik 2014/2015

VENDOSJA E RREGULLIT DHE RIORGANIZIM I QYTETIT

- Rrënimi i ndërtimeve ilegale (objekte pa leje, tejkalime të lejes së ndërtimit, si dhe lloje të tjera të ndërtimeve) - Gjatë vitit 2014 janë rrënuar 53 objekte, prej tyre 6 objekte për banim kolektiv, 9 objekte për banim individual si dhe objektet tjera përfshinin anekse, objekte afariste, garazhe, mure rrethuese, etj.
- Revokimi i gjitha lejeve që kanë rezultuar të jenë dhënë në mënyrë të jashtëligjshme.
- Largimi i transportuesve të kufomave nga përballë QKUK dhe rigjelbërimi i asaj pjese.
- Me qëllim përmirësimin dhe shtimin e sigurisë në transportin urban, Sektori i komunikacionit të Drejtorisë së Inspeksionit komunal, ka bërë konfiskimin e rreth 1200 automjeteve - taksi ilegal.

- ✓ Mbyllja e 23 lokaleve të lojërave të fatit - Meqë ligji për Lojërat e Fatit parasheh që këto të jenë të paktën 1.5 km larg institucioneve edukativo-arsimore, dhe të paktën 500m larg njëra tjetrës, Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Doganën dhe Agjensionin Tatimor të Kosovës ka bërë mbylljen e 23 lokaleve të lojërave të fatit.

IDENTIFIKIMI DHE SHTIMI I HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA

- ✓ Kemi identifikuar hapësirat e gjelbra të degraduara dhe krijimin e hartës me këto hapësira, identifikimin e gjendjes ekzistuese të tyre në terren, dhe rregullimin e tyre përmes ndërmarrjes 'Hortikultura'
- ✓ Identifikimin e lokacioneve të mundshme për realizimin e parqeve, të cilat do të jenë në shfrytëzim të qytetarëve. Si pasojë, janë hartuar projektet për parqe në disa lokacione të Prishtinës, të cilat më tutje janë plotësuar me paramasa dhe paralogari, që të jenë të gatshme për tenderim (realizim).
- Parkun tek "Posta Kryesore"
 - Parkun tek 'Rruga B' (përgjatë Rr. "Hyzri Talla" dhe Rr. "Enver Maloku")
 - Parku të Rrethi - Rruga "28 Nëntori"
 - Parku te BQK
 - Parku tek lagjja "Kodra e Trimave" (pranë shkollës 'Zenel Hajdini'),
 - Parku te 'Fusha e Pajtimit.
 - Parku të 'Salla 1 Tetori',
 - Parku të Kodra e Trimave (nën varrezat e qytetit)
- ✓ Mirëmbajtja dhe zgjerimi i gjelbërimit urban
- Mbjellja e luleve sezonale, 266,055 copë
 - Mbjellja e luleve shumëvjeçare, 49,000 copë
 - Mbjellja e drunjve dekorativ, 462 copë
 - Rikultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese, 10,000 m²



KU DO TE FOKUSOHEMI NE VITIN E ARDHSHËM ?

Ne jemi të kënaqur të raportojmë për realizimin e një numri të zotimeve që kemi dhënë në fillim të mandatit. Megjithatë, kjo nuk përbën një vetëkënaqësi sepse ka ende hapësirë për t'u përmirësuar. Përveç zotimeve që janë proces vitin e ardhshëm do të fokusohemi edhe në këto çështje:

- Zgjerimin e hapësirave të gjelbërta
- Udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në institucione arsimore
- Përfshirje e shtuar e fëmijëve në edukimin parashkollor
- Ngritje e cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm
- Zhvillimi profesional i mësimeve
- Organizimi i mësimit tërë-ditorë në shkollë
- Përmirësimi i kushteve për mësime dhe mësime cilësore
- Muzeu i shkencës
- Përmirësimin e infrastrukturës fizike të hapësirave shkollore
- Rritja e pjesëmarrjes së barabartë të grave në ushtrimin e të drejtave trashëgimore dhe pronësore
- Përmirësimi i vjeljes së tatimit në pronë
- Menaxhimi më i mirë i pronës komunale
- Inspektimi dhe mbikëqyrja inspektuese e ndërtimeve si dhe monitorimi i vendpunishteve
- Siguria në komunikacion
- Pastërtia e qytetit
- Siguria e përgjithshme
- Digjitalizimi i shërbimeve ndaj qytetarëve
- Fuqizimi i Bashkësive Lokale
- Vazhdimi i zbatimit të administrimit efektiv
- Krijimi i Qendrës komunale për këshillim në karrierë profesionale dhe promovim të punësimit tek të rinjtë
- Krijimi i qendrës për Business Process Outsourcing (BPO)
- Promovimi i bashkëpunimit ekonomik me qytete tjera nga vendet e ndryshme
- Përkrahja për zhvillimin e turizmit
- Promovimi i mundësive për investim
- Përkrahja e fermerëve në perimetari
- Zhvillimi i blegtorisë intensive
- Krijimi i kushteve për kthimin e qytetarëve dhe bizneseve në zonat rurale
- Pajisja e të gjitha institucioneve shëndetësore me mjete, aparatura dhe material tjetër të nevojshëm për punë
- Rritja e efikasitetit në punë dhe sigurimi i nevojshëm i barnave dhe materialeve të tjera hargjuese
- Krijimi i programit të veçantë të banimit
- Promovimi i shëndetit dhe ofrimi i këshillave
- Krijimi i qendrës për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta
- Decentralizimi dhe promovimi i kulturës
- Digjitalizimi i subvencioneve
- Funksionalizimi i objekteve kulturore

- Stimulimi i aktiviteteve të qëndrueshme sportive dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive
- Planet hapësinore, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe interesit qytetar
- Përpilimi i rregulloreve dhe udhëzuesve për të gjitha procedurat komunale
- Përmirësimi i kanalizimeve fekale
- Ri-ndërtimi i informacionit kadastral në dy lagje të qytetit të Prishtinës
- Përfundimi i projektit të regjistrimit të kadastrës të përçojave, objekteve nëntokësore dhe kadastrës etazhore të ndërtesave
- Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore



Komuna e Prishtinës
Rr. UÇK, 2 Prishtinë
Tel: 038 230 900
www.prishtinaonline.com

